



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

**Nr. 86 Akti**

**Nr. 71 Vendimi**

Tiranë, më 24.10.2018

### V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Xhensila Pine</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, më datë 23 tetor 2018, ora 13:30, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me adresë: Rruga e Kavajës, ish-godina e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Bujar Sheshi**, prokuror në Prokurorinë e Apelit për Krome të Rënda Tiranë, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, e të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (referuar më poshtë “Kushtetuta”)

**Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (referuar më poshtë ligji nr. 84/2016);

**Ligji nr. 44/2015** “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012** “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tri kriteret e vlerësimit: atë pasuror, atë të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, dhe, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur, më datë 15.01.2018, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shpërndarë me short çështja konkrete.

Në mbledhjen e trupit gjykues, më datë 24.01.2018, u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, znj. Pamela Qirko. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës gjyquese, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme.

Këto raporte u administruan nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)** ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport

të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.01.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, pasi ka mosdeklarim të pasurisë;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me atë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi.*

**Prokuroria e Përgjithshme** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\* prot., datë 03.05.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 10.10.2018, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit, më datë 10.10.2018. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes më datë 12.10.2018 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së shpjegimeve të tij më datë 15.10.2018.

Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 19.10.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 23.10.2018, ora 13:30, në sallën e seancave dëgjimore, në selinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me adresë: Rruga e Kavajës, ish-godina e "Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve", Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

### V. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
- f) deklaratimet e personave të tjerë të lidhur.

Në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 26.01.2017, **subjekti deklaroi këto pasuri** (të paluajtshme dhe të luajtshme) në emër të tij:

1. **Apartament banimi 1+1**, në Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, privatizuar nga Ndërmarrja Komunale e Banesave në vitin 1993. Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Blerë nga Ndërmarrje Komunale Banesa Nr. \*\*\*, Tiranë, pas privatizimit, më datë 28.07.1993.

**Në lidhje me këtë apartament, subjekti ka vënë në dispozicion:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit, me sip. 55.9 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, me numër pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\* dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme.

- Kontratë shitblerje, datë 27.07.1993, me palë shitëse: Ndërmarrjen Komunale Banesa dhe palë blerëse: Z. Bujar Sheshi, vërtetim noterial, datë 27.07.1993.
- Kontratë për privatizimin e banesës, datë 05.05.1993, formularin nr. \*\*\*, planimetrinë dhe planvendosjen.

#### **Hetimi i kryer nga Komisioni:**

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar UKT-së Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar OSHEE-së Tiranë.

#### **Arsyetimi ligjor:**

Apartamenti i banimit është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratë shitblerje të datës 27.07.1993 nga Ndërmarrje Komunale Banesa, Nr. \*\*\*, Tiranë, me çmim shitje në vlerën 9.260 lekë. Ky apartament është i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 55.9 m<sup>2</sup> dhe për të është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie, nr. \*\*\*, datë 07.01.2011. Në lidhje me këtë apartament nga ana e OSHEE-së dhe UKT-së konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratat përkatëse për furnizimin me ujë dhe energji elektrike.

Nisur nga vlera e vogël e privatizimit të kësaj banese, si dhe të ardhurat nga puna të subjektit dhe bashkëshortes së tij, arsyetohet se subjekti ka pasur aftësi paguese për këtë pasuri. Kjo pasuri rezulton e deklaruar nga subjekti që në deklarinimin fillestar të tij për vitin 2003.

- ✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

**1. Një dhomë shtesë** e këtij apartamenti ekzistues, e legalizuar në ALUIZNI - Tirana 2, me lejen nr. \*\*\*, datë 25.10.2015.

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Leja e legalizimit nga ALUIZNI - Tirana 2.

#### **Për këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. \*\*\*, vol \*\*\*, fq. \*\*\*, lëshuar më datë 16.12.2015, shoqëruar me hartën treguese.
- Kontratë e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 07.07.2015, me sip. 25.55 m<sup>2</sup>, me vlerë 15.336 lekë, formulari i pagesës së parcelës ndërtimore, faturë arkëtimi nr. \*\*\*, datë 24.06.2015, mandat bankar në “Credins Bank”, datë 25.06.2015.
- Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 25.10.2015, për objektin apartament + shtesë anësore, 5- katësh, në objektin ekzistues 5-katësh, me pjesë takuese, me sipërfaqe 4.467 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimore 22.55 m<sup>2</sup>.

#### **Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:**

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ALUIZNI-t Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.08.2018, drejtuar ILDKPKI-së.

### **Arsyetimi ligjor:**

Subjekti i rivlerësimit ka aplikuar pranë ALUZINI-t për legalizimin e dhomës shtesë, me kërkesë nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2006. Më datë 25.10.2015, nga ana e ALUZINI-t është lëshuar leja e legalizimit me nr. \*\*\*. Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë, rezulton se kjo pasuri është e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit.

Në deklarin e pasurisë për vitin 2015, subjekti e ka deklaruar për herë të parë këtë shtesë më vete (pasi kjo shtesë për herë të parë është deklaruar në vitin 2003 si pjesë e apartamentit në pronësi të subjektit të rivlerësimit), pas legalizimit dhe regjistrimit në ZVRPP-në Tiranë, më datë 16.12.2015. Në këtë formular, subjekti deklaron se ndërtimi i dhomës shtesë është bërë në vitin 1998 dhe se ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së kopjet e faturave dhe dokumentet shoqëruese (16 fletë). Pas kërkesës së bërë nga ana e Komisionit, ILDKPKI-ja informon se nuk rezulton të ketë bashkëngjitur dokumente shtesë, si dhe as fletë inventari. Në deklarin për herë të parë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar në pronësi apartament 2+1, duke përfshirë në apartamentin e privatizuar edhe ndërtimin e dhomës shtesë në anësore. Pyetjes sonë se, përse kjo shtesë është deklaruar për herë të parë, subjekti i është përgjigjur, më datë 13.09.2018, me arsyetimin, se pikërisht në këtë periudhë është bërë legalizimi dhe regjistrimi pranë ZVRPP-së Tiranë, duke marrë numër pasurie të veçantë.

Në lidhje me shpenzimet e kryera për këtë ndërtim, por të padeklaruara në vitin 2003, subjekti ka sqaruar se formulari i deklarin të pasurisë i vitit 2003, nuk kërkonte deklarin e shpenzimeve të ndërtimit. Kjo është arsyeja përse nuk është deklaruar nga ana e tij në vitin 2003 vlera e shpenzuar në lidhje me ndërtimin e kësaj shtese.

Për sa i përket shumës së shpenzuar për këtë ndërtim, subjekti sqaron se ndërtimi i dhomës shtesë në anësore është bërë në kuadër të shtesës anësore të bërë nga të gjithë banorët e pallatit 5-katësh. Firma ndërtuese është gjetur nga vetë banorët që në vitin 1997 dhe si fillim është paguar *cash* në vlerën 180.000 lekë, ndërsa diferenca prej 40.000 lekësh do të paguhej në përfundim të ndërtimit. Pasi firma ndërtuese u largua para përfundimit të punimeve, për shkak të situatës së 1997-tës, punimet janë përfunduar nga vetë banorët. Subjekti deklaron se punimet i ka përfunduar gradualisht duke shpenzuar një vlerë rreth 40.000 (dyzet mijë) ose 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Qoftë për shkak të rrethanave se si u largua firma ndërtuese, ashtu dhe për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, subjekti deklaron se nuk disponon dokumente për shpenzimet e bëra për ndërtimin e dhomës shtese. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i ka pasur mundësitë financiare për realizimin e këtij shpenzimi.

- ✓ Përputhet deklarin i subjektit me të dhënat nga dokumentet e administruara.
- ✓ Megjithëse subjekti nuk ka deklaruar shpenzimet për këtë pasuri në vitin 2003, kjo është e parëndësishme për shkak të vlerës së vogël të këtyre shpenzimeve.

**2. Banesë 1-katëshe (shtëpi përdhese 2+1) me oborr, me sip. të përgjithshme 162 m<sup>2</sup>, me adresë Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Tiranë, në bashkëpronësi në ½ pjesë me djalin e xhaxhait, z. M. Sh.**

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: fituar si trashëgimi nga halla e tij, znj. B. H, lënë me testament dhe njohur me vendim gjykate në bashkëpronësi 50 %.

**Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë me numër \*\*\*, ZK \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\* në pronësi të z. Bujar Sheshi dhe z. M. Sh (50 % / 50 %).
- Testament, nr. \*\*\* rep., datë 12.12.1994.
- Procesverbal i çeljes së testamentit nr. \*\*\*, datë 27.09.2012, nga trashëgimlënësja znj. B. H për trashëgimtarët z. Bujar Sheshi dhe z. M. Sh. Bashkëlidhur certifikata e vdekjes së znj. B. H., certifikata e pronësisë në emër të saj, lëshuar më datë 09.03.2000, harta treguese.
- Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, nr. \*\*\*, datë 19.12.2012.

### Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë

### Arsyetimi ligjor:

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkëpronësinë mbi një banesë 1-katëshe (2+1) me oborr, me sipërfaqe ndërtimore 94.06 m<sup>2</sup> dhe truall me sip. 162.28 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, përfituar si trashëgimi nga halla e tij znj. B. H., lënë me testament dhe njohur me vendim gjykate në bashkëpronësi me shtetasin M. Sh.

Me testamentin nr. \*\*\* rep., më datë 12.12.1994, përpara noterit publik L. H, znj. B. H, halla e subjektit ka dëshmuar vullnetin e saj, duke përcaktuar si trashëgimtarë të saj, pas vdekjes, dy nipërit, M. Sh dhe Bujar Sheshi, secilit me nga ½ pjesë të shtëpisë së banimit, në pronësi të trashëgimlënësës, përkatësisht kjo banesë njëkatëshe e përmendur më sipër.

Procesverbali i çeljes së këtij testamenti është mbajtur nga noterja publike, V. K, më datë 27.09.2012, pas vdekjes së trashëgimlënësës më datë 02.02.2012.

Me vendim nr. \*\*\*, datë 19.12.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është pranuar kërkesa për lëshimin e dëshmisë testamentare të trashëgimlënësës B. H., në favor të M. Sh e Bujar Sheshi në ½ pjesë secilit.

Bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë rezulton se kjo pasuri është e regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në pronësi 50 %.

Trashëgimlënësja e ka përfituar këtë pasuri nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë, të lëshuar me vendim nr. \*\*\*, datë 16.09.1981, të Gjykatës së Rrethit Tiranës.

Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga ana e subjektit, në deklaratën e pasurisë për vitin 2012, në të njëjtin vit që është regjistruar.

- ✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklaratimet e tij.

**3. Autoveturë tip, “Volkswagen Passat” e vitit 2002, model \*\*\*, me targë \*\*\*, blerë më datë 25.01.2005, në vlerën 7.000 euro, paguar tarifa doganore me vlerë 386.129 lekë.**

### Në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitje automjeti, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.01.2005, me palë shitëse shtetasin grek P. R.
- Vërtetim, nr. \*\*\* prot., datë 24.01.2005.
- Faturë doganore e zhdoganimit të mjetit për vlerën 386.129 lekë.

## Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

➤ Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

### Arsyetimi ligjor:

Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se e ka blerë këtë makinë në vlerën 7.000 euro, si dhe ka paguar tarifën doganore në vlerën 386.129 lekë.

Referuar dokumentacionit të procedurës së zhdoganimit të makinës, rezulton se zhdoganimi i këtij automjeti është kryer nëpërmjet deklaratës doganore \*\*\*, nr. \*\*\*, datë 28.01.2005. Totali i paguar pas draftit të rivlerësimit të bërë nga autoriteti doganor ka qenë në vlerën 408.329 lekë.

Në deklarinimin për herë të parë në vitin 2003, si dhe deklarinimin periodik të vitit 2004, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* të kursimeve (*përkatësisht gjendje më datë 31.12.2003 dhe më datë 31.12.2004*), si dhe nuk ka deklaruar detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë.

Referuar deklarinimit të tij periodik për vitin 2005, burimi i të ardhurave të përdorura për blerjen e autoveturës, më datë 25.01.2005, si dhe shlyerjen e detyrimeve përkatëse doganore, më datë 28.01.2005, mbetet i paqartë. Subjekti është pyetur për këtë fakt, por ai nuk ka qenë në gjendje të paraqesë prova, por thjesht sqarime.

Në deklarinimin e tij, më datë 13.09.2018, subjekti sqaron se: *“Për pagesën e zhdoganimit të makinës, kam shfrytëzuar lekët që kam siguruar nga shitja e automjetit tip “Audi”, të cilat i disponoja, pasi faktikisht e kisha shitur makinën pavarësisht se akti i shitjes është përpiluar disa ditë më vonë, kur është gjetur mundësia dhe koha, ndërmjet meje dhe blerësit që të shkonim para noterit.”*

Referuar analizës financiare të vitit të mbyllur 2005, rezulton që subjekti ka pasur të ardhura të vërtetuara të mjaftueshme për blerjet, shpenzimet dhe shtesat në vlera monetare në këtë vit.

Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në formularin e deklarinimit të pasurisë për vitin 2004 dhe jo atë të vitit 2005, që është viti kur realisht kjo pasuri është krijuar. Duke pasur parasysh faktin që subjekti në deklarinimin e vitit 2004 ka pasqyruar të dhënat e sakta të kontratës së shitblerjes, nuk mund të konkludohet se ka pasur ndonjë qëllim për të fshehur. Ky formular është depozituar në mars të vitit 2005, pra, kur mjeti ishte blerë.

- ✓ Përputhen të dhënat e subjektit me rezultatin e hetimit për këtë pasuri.
- ✓ Megjithëse subjekti nuk ka deklaruar kursime në vitet 2003 dhe 2004 dhe nuk është në gjendje të identifikojë burimin e të ardhurave për blerjen e autoveturës, më datë 25.01.2005, analiza financiare tregon se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme.

- **Llogari në “Raiffeissen Bank”, në shumën 2.500 euro.**

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: Kursime nga paga si prokuror.

### Subjekti ka vënë në dispozicion:

➤ Nxjerrje llogarie bankare nga “Raiffeissen Bank”, më datë 27.05.2016, me gjendje në shumën 2.500 euro.



### Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

➤ Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.02.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

Me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 02.02.2018, “Raiffeisen Bank” na informon për të gjitha lëvizjet e llogarisë në lekë dhe në euro të subjektit.

Me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 05.03.2018, “BKT”-ja na informon mbi llogarinë në euro në emër të z. Bujar Sheshi, në shumën 2.500 euro.

### Arsyetimi ligjor

Referuar shkresës me nr. \*\*\* prot., datë 02.02.2018, të “Raiffeisen Bank”, konfirmohet se z. Bujar Sheshi, disponon pranë kësaj banke llogarinë nr. \*\*\* në lekë, të dhënat për të cilën fillojnë nga data 31.03.2005, ku janë transferuar periodikisht pagat neto deri në fund të vitit 2009. Për periudhën 2005 - 2010, rezultojnë këto gjendje në fund të kësaj llogarie:

<b>Përshkrim</b>	<b>Vlera në lekë</b>
gjendje më datë 31.12.2005	50.311,02
gjendje më datë 31.12.2006	49.991,25
gjendje më datë 31.12.2007	303.203,22
gjendje më datë 31.12.2008	200.214
gjendje më datë 31.12.2009	403.916,34
gjendje më datë 31.12.2010	25.078,87

Më datë 25.11.2010, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr *cash* nga llogaria e mësipërme shumën prej 373.000 lekësh, duke depozituar në llogarinë nr. \*\*\*, në euro, në “Raiffeisen Bank” vlerën 2.500 euro. Kjo shumë ka kaluar në depozitë me afat 6 mujor, periodikisht deri më datë 04.12.2017, kur është tërhequr *cash* nga subjekti i rivlerësimit në vlerën 2.525 euro.

Nga dokumentacioni bankar i administruar, konstatohet se subjekti, ka depozituar pranë llogarisë në euro tek “BKT”, shumën prej 2500 eurosh, më datë 07.12.2017.

✓ Përputhen deklaratimet e subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

### 4. Pasuri e padeklaruar

Në raportin e ILDKPKI-së konstatohet se z. Bujar Sheshi dhe znj. M. Sh janë subjekte vetëdeklarues me anë të “Deklaratës së Përfshirjes në Procedurat e Legalizimit”, nr. \*\*\* prot.,

viti 2014. Nga verifikimet e kryera nga ILDKPKI-ja rezulton se ky aplikim ka të bëjë me shtesë në lartësi mbi objektet ekzistuese në pronësi të subjektit dhe nënës së tij, dhe jo me shtesën anësore të pallatit, për të cilën subjekti është pajisur me leje legalizimi.

Komisioni hetoi në lidhje me këtë, duke dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, një kërkesë për informacion me nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018.

Në përgjigjen e Drejtorisë së ALUIZNI-t Tiranë 2, me nr. \*\*\* prot., datë 08.02.2018, informohemi se prej tyre administrohet praktika e legalizimit e z. Bujar Sheshi dhe znj. M. Sh, me nr. \*\*\* prot., datë 24.09.2014, për legalizim për pasurinë e paluajtshme:

“Shtesë kati në lartësi me adresë Rr. “\*\*\*”, mbi pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap “\*\*\*\*” .

ALUIZNI Tiranë 2, konfirmon se kjo dosje nuk është trajtuar ende dhe është në fazën e procedurës së legalizimit. Në dosje administrohet vetëm dokumentacioni i paraqitur nga vetë subjekti.

Në deklaratën për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose shtesës në ndërtim me leje, subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, dhe personi i lidhur znj. M. Sh, deklarojnë se ndërtimi i shtesës në lartësi është kryer në vitin 2002.

Në gent-planin e paraqitur pranë ALUIZNI-t Tirana 2 nga z. Bujar Sheshi dhe personi i lidhur znj. M. Sh, rezulton se shtesa në lartësi është me sipërfaqe 133.8 m<sup>2</sup>. Shtesa është ndërtuar mbi apartamentet ekzistuese të subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, dhe personit të lidhur znj. M. Sh, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, pall \*\*\*, shk. \*\*\*, ap \*\*\*, Tiranë.

Në lidhje me këtë pasuri të padeklaruar, më datë 12.04.2018, subjektit iu kërkuar informacion shtesë.

Më datë 18.04.2018, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka bërë asnjë shtesë kati në lartësi, por është thjesht një mbulim i tarracës me tjegulla për të rregulluar problemet me hidroizolimim dhe termoizolimim. Meqenëse pallati është ndërtuar në vitin 1978 me kontribut vullnetar, për shkak të amortizimit, por dhe teknologjisë së ndërtimit, kanë pasur vazhdimisht probleme me lagështirën për shkak të ujit që depërtonte në tarracën e pallatit, e cila mbulonte dy apartamentet e sipërme. Subjekti pretendon se nuk është dhe as mund të shërbejë si sipërfaqe banimi, por është vetëm një çati e shtuar për të mbuluar strukturën. Legalizimin e saj, e ka kërkuar nga ALUIZNI-i, sepse banorët e tjerë të pallatit, edhe pse ligjërisht janë bashkëpronarë të tarracës, nuk janë të interesuar dhe nuk kanë kontribuar në asnjë rast për riparimet e saj, meqenëse dëmtimi i saj nuk sillte pasoja për banesat e tyre, sepse ishin të mbrojtura dhe të vetmit që dëmtoheshin, ishin apartamentet e katit të sipërm, të subjektit dhe nënës së tij.

Në lidhje me shpenzimet e kryera për këtë ndërtim, subjekti sqaron se ka mbuluar tarracën e pallatit (*në pjesën e sipërfaqes mbi apartamentin e tij dhe nënës së tij*) me një çati me tjegulla duke punësuar dy punëtorë të gjetur rastësisht, specialistë për ndërtimin e çative. Për punën e kryer, për tjegullat si dhe për ndonjë material tjetër ndihmës, subjekti deklaroi se ka shpenzuar në total një shumë prej rreth 200.000 lekësh. Për blerjen e tjegullave që kanë qenë ndoshta rreth 1.500 copë, ka paguar shumën prej 75.000 lekësh. Për shkak të kalimit të një kohe të gjatë, subjekti nuk ka mundur të na vërë në dispozicion faturën përkatëse. Në përfundim të qëndrimit të tij, subjekti deklaroi se nuk ka pasur si qëllim fshehjen e këtij ndërtimi, por nuk e ka konsideruar si ndërtim të mirëfilltë për t’u deklaruar pranë ILDKPKI-së. Për të vërtetuar

shpjegimet e tij, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit edhe fotografi nga shtesa në lartësi.

Për të sqaruar situatën, Komisioni iu drejtua drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana 2, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.05.2018, duke kërkuar informacion mbi llojin dhe destinacionin e ndërtimit, si dhe verifikimin në terren të tij.

Me shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.05.2018, kjo drejtori na informon se:

*“Nga verifikimi faktik i ndërtimit të deklaruar me adresë, Rr. “ \*\*\*”, pll. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, më datë 04.05.2018, u evidentua se mbi pasurinë ekzistuese nr. \*\*\*, ZK \*\*\*, të subjekteve Sheshi, konkretisht mbi paretet anësore të tarracës së pasurisë ekzistuese, ishte ndërtuar çati me tjegulla, e papërfunduar, e cila mbahej nga trarë druri.*

*Lartësia minimale e ndërtimit në skaje ishte 70 cm dhe ajo maksimale në kulm 246 cm. Ky ndërtim ishte i pashfrytëzueshëm në brendësi dhe për pasojë funksioni është i papërcaktuar. Hyrja për në këtë ndërtim mundësohej nëpërmjet çarjes për daljen në tarracën e pallatit, me anë të shkallëve të lëvizshme.*

*Në përgjigje të kërimit mbi vlerësimin e kushteve që plotëson ky ndërtim referuar kuadrit ligjor për legalizimin e ndërtimeve informale, informojmë se sipas germës “a”, neni 3, i ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, përcaktohet:*

*“Ndërtimi pa leje” është objekti, për të cilin është përfunduar karabinaja, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera (social kulturore, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e territorit.*

*Referuar gjendjes së faktit të lartpërshkruar dhe ligjit material/organik që trajton ndërtimet informale, vlerësojmë se **kjo strukturë nuk përbën ndërtim** sipas kushteve ligjore.”*

Nga ana e ALUIZNI-t Tirana 2 janë bërë matje dhe fotografime të këtij objekti. Ajo çfarë duket në këto fotografi përputhet edhe me fotografitë e vëna në dispozicion nga subjekti, dhe vërteton qartësisht se nuk kemi të bëjmë me një ndërtim funksional me qëllim banimin apo shfrytëzimin për veprimtari ekonomike.

Në bazë të këqyrjes në vend dhe matjeve nga ana e ALUIZNI-t Tirana 2, rezulton se kjo strukturë nuk përbën ndërtim sipas kushteve ligjore. Duke mos përbërë ndërtim, kjo strukturë nuk mund të kualifikohet si pasuri e paluajtshme. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e tij, është shprehur se nuk e ka deklaruar këtë strukturë, pasi nuk e ka konsideruar si pasuri të paluajtshme dhe vlerat monetare të harxhuara për ndërtimin e saj nuk e kalojnë tavanin e kërkuar në deklaratimet periodike pranë ILDKPKI-së.

Në përfundim, subjekti nuk ka kryer mosdeklarim të pasurisë, për aq kohë sa nga vetë institucioni kompetent, ALUIZNI, ky ndërtim nuk plotëson kushtet e klasifikimit si pasuri/ndërtim.

✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklaratim.

**Në emër të personit të lidhur, bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. Aida Sheshi, subjekti ka deklaruar:**

1. Apartament banimi, me sip 59.7 m<sup>2</sup>, Rr.“ \*\*\*”, Tiranë, pjesë takuese: 50 %. Në bashkëpronësi me shtetasin I. J. Vlëra e deklaruar 4.225 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: fituar si trashëgimi nga prindërit, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.01.2016, në bashkëpronësi: 50 % me vëllain.

#### **Subjekti ka vënë në dispozicion:**

➤ Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit me sip. 59.7 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*”, godina \*\*\* h. \*\*\*, ap. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\* dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme, hartën treguese.

#### **Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:**

➤ Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

#### **Arsyetimi ligjor:**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi me pjesë takuese 50 % në pronësi të bashkëshortes së tij, me sip. 59.7 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*”, Tiranë, dhe bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë rezulton se kjo pasuri është e regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit dhe shtetasit I. J (vëllai i bashkëshortes së subjektit).

ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. \*\*\*, datë 15.02.2018, bashkëlidhur vuri në dispozicion dëshminë e trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.01.2016, ku A. Sh e I. J trashëgojnë në pjesë të barabarta pasurinë e lënë nga prindërit e tyre H. e P. J. Trashëgimlënësit e kanë përfituar këtë apartament nëpërmjet privatizimit me anë të kontratës së datës 13.08.1993.

✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij

2. **Depozitë në “BKT”** në shumën 20.038,31 USD, 10.059,49 euro dhe një kontratë bono thesari me vlerë 500.000 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: e ardhur nga pjesa takuese e kompensimit të pronës nga AKKP-ja, sipas VKM-së, nr. \*\*\*, datë 19.05.2010, nga data 7.10.2010 deri më datë 22.04.2016, në vlerat e konvertuara nga banka.

#### **Subjekti ka vënë në dispozicion:**

➤ Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, i “BKT”-së.

#### **Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:**

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.03.2018, drejtuar ATP-së.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.04.2018, drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.
- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.08.2018, drejtuar ALUIZNI-t.

### Arsyetimi ligjor:

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit është trashëgimtare e z. M. K (gjyshi saj). Me vendimi nr. \*\*\*, datë 16.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë, sipas së cilës ajo përfitonte 1/8-tën pjesë të pasurisë së gjyshit.

Të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga kompensimi i pronës (pjesë takuese) nga AKKP-ja, kanë kaluar në formë depozite në “BKT”, gjendje në vlerë 20.038.31 USD, në vlerë 10.059,49 euro dhe kontratë bono thesari në vlerë 500.000 lekë.

Sipas shkresës, nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, të “BKT”-së, të ardhurat si pjesë takuese nga kompensimi i pronës kanë kaluar në llogarinë nr. \*\*\* në lekë, pranë kësaj banke në emër të bashkëshortes me nga një këst në vit në vlerë totale 5.699.500 lekë për periudhën 2010 - 2016.

Këto të ardhura janë deklaruar nga subjekti, në deklarimet periodike, në vlerë totale 5.779.500 lekë. Kalimi në kohë dhe në vlerë i këtyre shumave (referuar deklarimeve dhe shkresës së sipërcituar), paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Viti	E ardhur nga kompensimi (deklarim i subjektit në lekë)	E ardhur nga kompensimi sipas shkresës së “BKT” në lekë	Ndryshimi
2010	1.680.000	1.600.000	80.000
2011	1.159.500	1.159.500	0
2012	750.000	750.000	0
2013	740.000	740.000	0
2015	450.000	450.000	0
2016	1.000.000	1.000.000	0
<b>Totali</b>	<b>5.779.500</b>	<b>5.699.500</b>	<b>80.000</b>

Rezulton një diferencë në deklarimin periodik të vitit 2010, ku subjekti ka deklaruar 80.000 lekë më shumë, referuar dokumenteve bankare të ardhura nga “BKT”-ja. Në lidhje me këtë rezultat është pyetur subjekti, i cili, më datë 13.09.2018, ka sqaruar se mund të jetë bërë një lapsus nga ana e tij, për shkak të plotësimit me shkrim dore të mandatpagesës së bankës, ku shifrat 8 dhe 0 mund të jenë lexuar gabim, ose për shkak të plotësimit të formularit me kompjuter, mund të jetë ngatërruar në shkrimin e dy numrave.

Transfertat janë kryer nga F. Z, në cilësinë e personit të autorizuar me prokurë.

Bazuar në shkresën e “BKT”-së rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka pasur:

- Llogari depozitë, nr. \*\*\* në euro.

Veprimet në këtë llogari kanë filluar, më datë 08.10.2010, me një transfertë hyrëse nga llogaria në lekë me këmbim, në vlerë 10.000 euro.

Ky transaksion është kryer 1 (një) ditë pas transfertës, në vlerë 1.600.000 lekë (datë 07.10.2010), si pjesë takuese e kompensimit të pronës nga AKKP-ja, për znj. A. Sh.

Lëvizjet në llogarinë depozitë në euro paraqiten si më poshtë:

**Llogari nr. \*\*\*, A. Sh, “BKT”.**

Veprimi	Data e veprimit	Vlera euro	Vlera lekë	Data e veprimit	Vlera euro	Vlera lekë	Vlera interes euro	Vlera interes lekë
Depozitim	08.10.2010	10.000	1.387.700					
Interes i paguar				08.04.2011			112,19	15.586,5567
Rikthim depozite				12.04.2011	10.000	1.389.300		
Depozitim	12.04.2011	10.112,2	1.404.887					
Interes i paguar				11.10.2011			82,13	11.410,3209
Rikthim depozite				11.10.2011	10.112,2	1.404.886,6		
Depozitim	11.10.2011	10.145	1.409.442					
Rikthim depozite				18.06.2014	10.145	1.421.717,5	358,48	50.237,3872
Depozitim	18.06.2014	10.000	1.401.400					
Rikthim depozite				30.03.2017	10.063,7			

- Llogari depozitë, nr. \*\*\* në USD.

Veprimet në këtë llogari kanë filluar, më datë 23.03.2011, me një transfertë hyrëse nga llogaria në lekë me këmbim, në vlerë 10.000 USD (990.000 lekë), më datë 24.03.2011, kjo shumë kalon në depozitë me afat.

Ky transaksion është kryer disa ditë pas transfertës në vlerë 1.159.500 lekë (datë 18.03.2011), si pjesë takuese e kompensimit të pronës nga AKKP-ja, për znj. A. Sh (kësti i dytë).

Lëvizjet në llogarinë depozitë në USD, paraqiten si më poshtë:

**Llogari nr. \*\*\*, A. Sh, “BKT”.**

Veprimi	Dtata e veprimit	Vlera USD	Vlera lekë	Data e veprimit	Vlera USD	Vlera lekë	Vlera interes USD	Vlera interes lekë
---------	------------------	-----------	------------	-----------------	-----------	------------	-------------------	--------------------

Depozitim	24.03.2011	10.000	1.075.400					
Rikthim depozite				24.03.2014	10.000	1.152.300	435,34	50.164,228
Depozitim	24.03.2014	10.000,3	1.152.339,2					
Rikthim depozite				24.03.2016	10.000,3	1.282.943,6	153,85	19.737,417
Depozitim	24.03.2016	10.000	1.282.900					
Depozitim	25.04.2016	7.000	898.030					
Depozitim	25.08.2016	3.000	384.870					
Interes i paguar				20.09.2016			13,23	1.697,2767
Rikthim depozite				20.09.2016	7.000	898.030		
Depozitim	21.9.2016	7.013,23	899.727,28					

Bazuar në shkresën, nr. \*\*\*prot., datë 27.04.2018, të ATP-së rezulton se:

**Përfaqësuesja me prokurë e bashkëpronarëve K., znj. B. K:**

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 23.09.2010 (*xhirimi nr. \*\*\*, datë 29.09.2010*), kësti i parë: 21.89 %, është transferuar në llogarinë e saj, nr. \*\*\*, pranë “BKT”-së, në shumën **53.980.810 lekë**.

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 07.03.2011 (*xhirimi nr. \*\*\*, datë 09.03.2011*), vlera është 37.113.348.64 lekë.

Për shumat e mësipërme në vlerë totale 91.094.158 lekë, ½ e shumës (*1680/3360 pjesë*) ose 45.547.079 lekë i takojnë trashëgimtarëve të z. Sh. K.

**Përfaqësuesja me prokurë e bashkëpronarëve, znj. F. Z:**

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 20.04.2012 (*xhirim nr. \*\*\*, datë 23.04.2012*), me llogari nr. \*\*\*, pranë “Credins Bank”, në vlerën 12.403.996 lekë.

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 07.06.2013 (*xhirim nr. \*\*\*, datë 11.06.2013*), në “Credins Bank”, në vlerën 12.330.016 lekë.

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 14.04.2016 (*xhirim nr. \*\*\*, viti 2016*), në “Credins Bank”, në vlerën 16.029.021 lekë.

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 06.07.2015 (*xhirim nr. \*\*\*, datë 14.07.2015*), në “Credins Bank”, në vlerën lekë 7.951.628 lekë.

- Referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 14.04.2016 (xhirim nr. \*\*\*, viti 2016), në “Credins Bank”, në vlerën 1.813.529 lekë.

Sipas vendimeve të mësipërme, për trashëgimtarët e z. Sh. K (pjesë e të cilëve është edhe A. Sh me kuota në vlerë 105/3360 të totalit të pasurisë), është kaluar në total vlera prej 96.075.269 lekësh. Referuar të dhënave nga “BKT”-ja, për znj. A. Sh, rezulton se pagesat nga F. Z janë kryer në këstet si më poshtë:

Data e transfertës	Shuma në lekë	Urdhërues
07.10.2010	1.600.000	F.Z
18.03.2011	1.159.500	F.Z
24.04.2012	750.000	F.Z
16.06.2013	740.000	F.Z
16.07.2015	450.000	F.Z
22.04.2016	1.000.000	F.Z
<b>Totali</b>	<b>5.699.500</b>	

Referuar kuotave përkatëse, për znj. A. Sh, duhej të transferohej vlera prej 6.004.704 lekësh (96.075.269 lekë\*2\*105/3360), me një diferencë në vlerë prej 305.204 lekësh, të cilat nuk i kanë kaluar ende.

Gjatë hetimit administrativ rezultoi se pasuria nr. \*\*\*, bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë rezulton se është ende në pronësi të znj. A. Sh dhe bashkëpronarëve të tjerë, pavarësisht se për këtë pasuri ajo është trajtuar nga ATP-ja me kompensim financiar. Duke qenë se kjo pasuri është ende në pronësi të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit ajo duhej të deklarohet në deklaratën “Vetting”. Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime.

Në përgjigjen e tij ai sqaron se: “Origjina e pasurisë që sot mban nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, Z.K. \*\*\* Tiranë, është vendimi nr. \*\*\*, datë 04.09.1996, “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave”, i cili ka vendosur të njohë si ish-bashkëpronar shtetasit Sh. K dhe S. K duke iu kthyer trashëgimtarëve të tyre sipërfaqen prej 2x10.000 m<sup>2</sup>, pra 20.000 m<sup>2</sup> (e cila më vonë pas azhurnimit të bërë kryesisht nga ZRPP-ja Tiranë rezultoi 19.734 m<sup>2</sup>). Në zbatim të vendimit të KKKP-së, nr. 1060, datë 04.09.1996, është bërë edhe regjistrimi i kësaj prone në ZRPP-në Tiranë në emër të trashëgimtareve të Sh. dhe S. K, që në atë kohë ka qenë edhe gjyshi i bashkëshortes sime, i ndjeri M. K, i biri i Sh.. Në vitin 2009, pasi i ndjeri M. K dhe bashkëshortja e tij kishin ndërruar jetë, është bërë çelja e dëshmisë së trashëgimisë ligjore me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në bazë të këtij vendimi rezultoi si trashëgimtare edhe bashkëshortja e tij, që sipas përlllogaritjes së ZRPP-së kishte 105/3360 pjesë të pasurisë që ju përmendni. Që nga momenti kur bashkëshortja ka fituar të drejtën e



*bashkëpronësisë mbi këtë pronë, kjo zonë ka qenë klasifikuar si zonë informale, pasi ishte e zënë e gjitha me ndërtime informale. Për pasojë, në asnjë moment asnjëri prej bashkëpronarëve, duke përfshirë edhe bashkëshorten time, nuk ka pasur asnjë tagër pronësie mbi këtë pasuri (posedim shfrytëzim dhe disponim). Kjo ka qenë dhe arsyeja pse nuk është përmendur në deklaratimet e pasurisë, as pranë ILDKPI-së dhe as në deklaratën "Vetting". E vetmja e drejtë pasive që gëzojm mbi këtë pronë ishte ajo e kompensimit të cilën e kam deklaruar rregullisht."*

Për të vërtetuar sqarimin e subjektit, Komisioni, i është drejtuar ALUIZNI-t me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.08.2018. Kjo drejtori, në shkresën e saj nr. \*\*\*prot., datë 07.09.2018, na informon se prona me sipërfaqe 19.734 m<sup>2</sup> është e zënë nga ndërtime informale në proces legalizimi, por akoma nuk janë kompensuar bashkëpronarët V., K., Sh., etj., prandaj rezultojnë ende pronarë të kësaj pasurie.

I njëjti informacion administrohet edhe nga përgjigja e ZVRPP-së Tiranë dërguar me shkresën, nr. \*\*\*prot., datë 18.09.2018.

✓ Përputhet deklarimi i subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

**3. Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*,** lloji i pasurisë apartament, me sip. 73.3 m<sup>2</sup>, e cila është transkriptuar në favor të të tretëve në bazë të kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 08.06.2005, e padeklaruar në vitin 2005.

#### **Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:**

➤ Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. \*\*\*, datë 15.02.2018, konfirmon këtë pasuri të tjetërsuar.

#### **Arsyetimi ligjor:**

Znj. A. Sh (J.), ka përfituar **3 nga të 240**-at pjesë takuese të kësaj pasurie, regjistruar më datë 02.06.2005, në ZVRPP-në Tiranë me anë të dëshmisë së trashëgimisë lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. \*\*\*, datë 22.04.2005. Janë shitur pjesët takuese të 10 trashëgimtarëve me pjesë të vogla takuese (*total 42 nga të 240-at pjesë*), ku përfshihet dhe znj. A. Sh, ndaj 4 trashëgimtarëve me pjesë takuese të mëdha (*total 198 nga të 240-at pjesë*) për vlerën 500.000 lekë. Pjesa takuese e znj. A. Sh pas shitjes është në vlerën **35.714** lekë. Kjo pasuri si dhe shuma e përfituar nga shitja e saj nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2005. Nga verifikimi i deklaratës së interesave private të vitit 2005 rezulton se ajo nuk është plotësuar në asnjë nga rubrikat e saj.

Pasuria e fituar me anë të trashëgimisë nuk ka ardhur si pasojë e detyrës së subjektit dhe pjesa takuese e bashkëshortes së tij është shumë e vogël (*3 të 240-tat pjesë*). Kjo pasuri është tjetërsuar vetëm dy muaj pasi është fituar dhe shuma që ka përfituar subjekti është e papërfillshme, vetëm **35.714** lekë.

✓ Duke qenë se prona është shitur që në vitin 2005, subjekti nuk ka pasur detyrimin për ta deklaruar në deklaratën “Vetting”.

**Në emër të personit të lidhur, nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. M. Sh, subjekti ka deklaruar:**

**1. Apartament banimi**, me sip. 55.9 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, pjesë takuese: 100 %. Vlera e deklaruar 8.656 lekë.

Burimi i deklaruar i krijimit, sipas deklaratës “Vetting”: blerë nga Ndërmarrje Komunale Banesa Nr. \*\*\*, Tiranë, pas privatizimit më datë 27.07.1993.

**Subjekti ka vënë në dispozicion:**

- Certifikatë për vërtetim pronësie të apartamentit me sip. 55.9 m<sup>2</sup>, në Rr. “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, me numër pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\* dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme.
- Kontratë shitblerje datë 27.07.1993, me palë shitëse, Ndërmarrjen Komunale Banesa dhe palë blerëse, znj. M. Sh, vërtetim noterial datë 27.07.1993.
- Kontratë për privatizimin e banesës, datë 05.06.1993, formularin nr. \*\*\*, planimetrinë dhe planvendosjen.

**Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:**

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

**Arsyetimi ligjor:**

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, ka deklaruar apartament banimi të nënës së tij, me sipërfaqe 55.9 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë. Bazuar në shkresën, nr. \*\*\* prot., datë 15.02.2018, të ZVRPP-së Tiranë, rezulton se kjo pasuri është e regjistruar në emër të nënës së subjektit. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar vlerën e kësaj pasurie, por nga kontrata e shitblerjes nga Ndërmarrja Komunale e Banesave, datë 27.07.1993, rezulton në vlerën 8.656 lekë. Nisur nga fakti se nëna e subjektit është pjesëtare në certifikatën familjare të subjektit, si dhe nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij, arsyetohet se kanë pasur mundësi financiare për këtë pasuri.

✓ Subjekti ka qenë i saktë në deklarinimin e tij.

**2. Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\***, lloji i pasurisë truall, me sip. 604 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 241 m<sup>2</sup>, në Tiranë. (Pasuri aktive në bashkëpronësi me pjesë 1/8) e padeklaruar nga subjekti.

**Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:**

- Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 25.01.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

Me shkresën nr. \*\*\*, datë 15.02.2018, ZVRPP-ja Tiranë na informon se në emër të znj. M. Sh figuron pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK \*\*\*, lloji i pasurisë truall, me sip. 604 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 241 m<sup>2</sup> në Tiranë, (*pasuri aktive*), në bashkëpronësi me 1/8 pjesë.

➤ Shkresë nr. \*\*\*prot., datë 24.09.2018, drejtuar ZVRPP-së Tiranë.

Me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 24.09.2018, ZVRPP-ja Tiranë, na informon rreth statusit të kësaj prone.

### **Arsyetimi ligjor:**

Në bazë të dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë rezulton se znj. M. Sh (B.) është një prej 8 trashëgimtarëve që kanë përfituar këtë pronë regjistruar, më datë 01.02.2007, me anë të dëshmisë së trashëgimisë lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendim nr. \*\*\*, datë 23.12.2005. Kjo pasuri nuk rezulton e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në asnjë nga deklaratat e interesave private periodike, por dhe në deklaratën “Vetting”.

Më datë 12.09.2007, kjo pasuri është vënë në favor të shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në ZVRPP-në Tiranë, në bazë të kontratës për dhënie pasurie për ndërtim me shkëmbim sipërfaqe ndërtimore, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.08.2007, me firmën “\*\*\*\*” sh.p.k., me përfaqësues z. A. V.

Pjesa përfituese e palës bashkëpronare është 42 % e sipërfaqes ndërtimore, por jo më pak se 2.07 m<sup>2</sup> ndërtim për çdo metër katror truall që vihet në dispozicion.

Në lidhje me këto konstatime subjektit të rivlerësimit i është kërkuar informacion shtesë. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *“Që në fillim ju sqaroj se prona truall me sip. 604 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 241 m<sup>2</sup> (pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, ZK. \*\*\*) nuk është zhvilluar. Kontrata me firmën “\*\*\*\*” sh.p.k., me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.08.2007, është anuluar nga palët. Në atë banesë me oborr, banojnë aktualisht, si dhe më parë, tre nga vëllezërit e nënës sime, së bashku me familjet e tyre. Nëna e tij, pas martesës është larguar nga banesa prindërore me prikë dhe nuk ka pasur dhe as nuk ka pretendime pronësie. Në familje nuk është diskutuar ndonjëherë për të drejta pronësie mbi këtë pasuri. Kjo është arsyeja që unë nuk kam qenë në dijeni të faktit se nga ana e saj është nënshkruar së bashku me vëllezërit e saj, një kontratë me një firmë ndërtimi, për të ndërtuar mbi atë truall një pallat. Firma i është kërkuar nga vëllezërit e saj të interesuar për atë ndërtim për shkak të nevojave që kanë për strehim, pasi kishin nxjerrë më parë dëshminë e trashëgimisë mbi pronën, sipas të cilës ajo rezulton se kishte pjesë me 1/8 e pasurisë (bashkëlidhur dëshmia e trashëgimisë).”*

ZVRPP-ja Tiranë, me anë në të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.09.2018, na informon se kjo pasuri është në pronësi të bashkëpronarëve B. (10 bashkëpronarë sipas listës me ref. \*\*\*). Nga verifikimi i hartës treguese dhe kartelës së pasurisë nuk rezulton që mbi këtë pasuri të ketë ecuri në lidhje me zhvillimin e pronës.

Nga analiza e dokumentacionit të grumbulluar nga hetimi administrativ, si dhe deklaratimet e subjektit, konstatohet se burimi i krijimit të kësaj pasurie nga nëna e subjektit të rivlerësimit është i ligjshëm pasi rrjedh nga trashëgimia dhe nuk mund të ketë lidhje me detyrën e subjektit të rivlerësimit. Vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka kontribuar në krijimin e saj dhe është shprehur se nuk ka pasur dijeni për të, pasi nëna e tij nuk e ka poseduar këtë pasuri, ajo ka jetuar gjithmonë me subjektin e rivlerësimit. Duke marrë në konsideratë faktin që kjo pasuri rrjedh nga trashëgimia si dhe faktin që nëna e subjektit të rivlerësimit, e cila ka ndërruar jetë, nuk ka pasur pretendime mbi këtë pasuri, mosdeklarimi i saj nga ana e subjektit të rivlerësimit rrjedh nga mosdhënia e informacionit të plotë nga nëna e tij.

✓ Nuk konkludohet se mosdeklarimi është bërë me qëllim fshehjen e pasurisë së vënë në mënyrë të paligjshme.

### **Konkluzion përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë**

Në lidhje me mungesën e deklarimeve të evidentuara më sipër, konkludohet se subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, nuk ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave apo pasurisë së tij apo personave të lidhur me të. Është i qartë fakti se pasuria e personit të lidhur me të, e padeklaruar, është rrjedhojë e trashëgimisë ligjore dhe nuk lidhet me punën apo të ardhurat e subjektit. Shuma e vogël e padeklaruar e shpenzimeve në vitin 2003 nuk krijon dyshime mbi mënyrën e krijimit të këtyre të ardhurave. Nga analiza financiare ndër vite rezulton se subjekti ka pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera. Pasaktësitë e konstatuara janë shpjeguar bindshëm dhe nuk lindin dyshime të arsyeshme për veprime që mund të ndikojnë në rivlerësim.

Duke e bazuar gjykimin mbi parimin e proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin e përgjithshëm të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se pasaktësitë e konstatuara në këtë rast nuk reflektojnë negativisht në pozicionin e prokurorit apo të cenojnë besimin e publikut tek drejtësia.

Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe vlera e pasurisë së tij nuk kalon dyfishin e pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në kohë, sipas ligjit. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

## **VI. VLERËSIMI I FIGURËS**

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Nga hetimi administrativ nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Për subjektin e rivlerësimit konstatohet se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si prokuror.

## VII. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

**Prokuroria e Përgjithshme (PP)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. \*\*\*prot., datë 03.05.2018.

Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, është bazuar në:

1. Formularit të vetëdeklarimit si dhe të 3 (tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
2. 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistem objektiv dhe rastësor;
3. Të dhënat nga burimet arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, struktura të tjera të Prokurorisë së Përgjithshme dhe ato të administruara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

Vlerësimi i aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, i bazuar në gjetjet e këtij raporti, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet si më poshtë:

### 1. Lidhur me aftësitë profesionale

#### a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Bujar Sheshi, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, e analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e lidhur përmbajtjen e saj me akte të tjera ligjore dhe nënligjore apo me praktikën gjyqësore, kryesisht atë unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Në rastin e çështjeve me natyrë procedurale, përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim. Ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. Identifikon rastet kur norma ligjore plotësohet nga akte nënligjore. I kushton rëndësi analizës së provave të administruara.

Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Aktet janë përgatitur prej tij, në respektim të dispozitave procedurale penale por edhe të urdhrit nr. \*\*\*, datë 05.09.2003, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për pasqyrimin me shkrim të qëndrimit të prokurorit në seancë gjyqësore”. Aktet e përpiluara prej tij, janë ruajtur në sekretarinë e prokurorisë, në respektim të plotë të urdhrit.

Mbështetur në nenet 418, 432 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale si dhe në udhëzimin nr. 1, datë 14.11.2008, “Për ushtrimin me efikasitet të së drejtës së ankimit”, prokurori Bujar Sheshi, ka respektuar procedurat për ushtrimin e rekursit, mbështetjen apo jo të ankimit të prokurorit.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurorit Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

## **b) Arsyetimi ligjor**

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, ka aftësi në arsyetim ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimin dhe përdor përgjithësisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të aktit të përgatitur prej tij. Aktet e përpiluara prej tij, konceptohen me tri pjesë. Përgjithësisht, përmbajtja e aktit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje çështjeve që parashtrihen për zgjidhje. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore dhe provave.

Niveli i arsytimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

## **2. Lidhur me aftësinë organizative**

### **a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë**

Subjekti rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, në periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiorë dhe kohore, prokurori Bujar Sheshi, subjekt rivlerësimi, për shkak të detyrës që ka kryer, analiza e të dhënave të tij bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Ai ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet.

Nga analiza e 5 (pesë) çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij, ka ndodhur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Bujar Sheshi, është eficient dhe efektiv. Në efektivitetin dhe efikasitetin e veprimtarisë së tij nuk ka

ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë e lartë, duke pasur parasysh edhe specifikën e çështjeve të ndjekura nga Prokuroria për Krimeve e Rënda, të cilat paraqesin kompleksitet. Në këtë drejtim duhet evidentuar se koha është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

#### **b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore**

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, ka ushtruar detyrën si prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, ku evidentohet se ka marrë pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar organin e akuzës. Konstatohet se është i aftë profesionalisht në këtë pjesëmarrje dhe për qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë organizative të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

#### **c) Aftësia për të administruar dosjet**

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik përgjithësisht, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorëve, disponimin e gjykatave.

### **3. Lidhur me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale**

#### **a) Etika në punë**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, konstatohet se ky prokuror, përveç funksionit të tij në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokurorinë pranë

Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, nuk ka të dhëna për angazhime të tjera profesionale.

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, 08.10.2013 - 08.10.2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurorin Bujar Sheshi, nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për etikën profesionale të treguar prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

#### **b) Integriteti**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### **c) Paanësia**

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurori Bujar Sheshi. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Bujar Sheshi, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

### **4. Lidhur me aftësitë personale dhe angazhimin profesional**

#### **a) Aftësitë e komunikimit**

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej tij, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.



Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e komunikimit të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

#### **b) Aftësia për të bashkëpunuar**

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Bujar Sheshi, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, për vitet 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se:

I. Për vitin 2015 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

II. Për vitin 2016 - subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit të treguara prej tij, bazuar në të njëjtin vlerësim të bërë nga drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë.

#### **c) Gatishmëria për t’u angazhuar**

Subjekti i rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, nuk rezulton të jetë angazhuar në veprimtari të ndryshme nga ajo e prokurorit dhe as të ketë qenë pjesëmarrës në trajnime.

Sipas të dhënave të regjistrit të denoncimeve, pranë Komisionit, nuk është paraqitur asnjë denoncim për këtë subjekt.

Pas shqyrtimit të Raportit të hartuar nga Grupi i Punës i Prokurorisë së Përgjithshme, si më sipër, trupi gjykues nuk gjeti asnjë indice apo elementë që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

### **KONKLuzioni Përfundimtar**

Pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Bujar Sheshi, në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të

vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale,

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59 pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit e rivlerësimit, z. Bujar Sheshi.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 24.10.2018.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**PAMELA QIRKO**

**Kryesuese**

**XHENSILA PINE**

**Anëtare**

**GENTA TAFA (BUNGO)**

**Relatore**

**ANISA DUKA**

**Sekretare gjyqësore**